



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 409-33253 /2024

Klinë, datë 09/10/2024

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar, me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës, të dt. 07.04.2010, dispozitat e nenit 21 të Rregullores së MF-nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, me qëllim të përmbushjes së këtyre obligimeve, Kryetari i Komunës së Klinës, **merr;**

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare të komunës së Klinës dhe organeve vartëse të saj.

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për vlerësimin e pasurisë jo financiare të administratës komunale, institucioneve shëndetësore dhe atyre arsimore, në këtë përbërje:
 - 1.1. **Driton Berisha**, kryesues;
 - 1.2. **Blerin Hoti**, anëtar;
 - 1.3. **Visar Bojaj**, anëtar;
2. Komisioni si nga pika 1 e këtij vendimi është i obliguar që për punën e vet të përgatit raportin për vlerësimin e pasurisë në përputhje me dispozitat e Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, të cilin raport ja paraqet Drejtorisë së Financave, si dhe një kopje kryetarit të komunës dhe atë më së largu deri në pjesën e pare të muajit dhjetor 2024.
3. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- DFEZH;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaj

